

Raporti i vitit 2021 mbi trafikimin e personave

KOSOVA (Niveli 2)

Qeveria e Kosovës nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, por është duke bërë përpjekje të mëdha për ta bërë këtë. Qeveria demonstroi përpjekje të shtuara në krahasim me periudhën paraprake të raportimit, duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë COVID-19 në kapacitetin e saj kundër trafikimit; prandaj, Kosova mbeti në Nivelin 2. Këto përpjekje përfshinin miratimin e procedurave të reja standarde të operimit (PSO) për ta rritur efikasitetin e ndjekjeve penale dhe caktimin e një personi kontaktues për trafikim në të shtatë prokuroritë themelore. Qeveria i rriti burimet për mbrojtjen e viktimave, përfshirë fondet për strehimoret kundër trafikimit të drejtuara nga OJQ-të dhe strehimoret e drejtuara nga shteti. Megjithatë, qeveria nuk i përmbushi standardet minimale në disa fusha kryesore. Qeveria dënoi më pak trafikantë dhe gjykatësit vazhduan të shqiptonin dënime të buta për trafikantët e dënuar. Reaguesit e parë nuk kishin udhëzime se si t'i trajtonin dhe identifikonin në mënyrë aktive viktimat e lypjes së detyruar, posaçërisht fëmijët. Për shkak të pandemisë, Agjencia Kombëtare Kundër Trafikimit të Personave (AKKTP) nuk mbante rregullisht takime dhe qeveria nuk e miratoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit 2020-2024.

REKOMANDIMET ME PËRPARËSI:

Energjikisht t'i hetojë, ndjekë penalisht dhe dënojë trafikantët, përfshirë zyrtarët e përfshirë në krime të trafikimit, dhe t'u shqiptojë trafikantëve dënime me burg në përputhje me dënimet e përcaktuara. • Të zhvillojë udhëzime me shkrim dhe t'i përmirësojë përpjekjet për t'i identifikuar dhe për t'u ndihmuar fëmijëve që shfrytëzohen për lypje të detyruar. • Ta miratojë, të sigurojë burime dhe ta zbatojë Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Trafikimit 2020-2024. • Të caktojë prokurorë dhe gjykatës të trajnuar në çdo rajon për t'i trajtuar rastet e trafikimit. • Të vazhdojë të ofrojë trajnim të avancuar për gjykatës, prokurorë dhe për organet për zbatim të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit. • Ta pakësojë numrin e rasteve të pazgjdhura gjyqësore, përfshirë rastet e trafikimit. • Të punojë me autoritetet lokale për ta forcuar mbrojtjen e viktimave në tërë Kosovën, posaçërisht në komunat veriore. • Ta rrisë mbështetjen qeveritare për trajnim gjithëpërfshirës profesional dhe shërbime të riintegrit për viktimat. • Ta standardizojë mbledhjen e të dhënave dhe ta krijojë një bazë të të dhënave që i zbërthen statistikat për trafikim dhe ndjekje penale e dënim për raste të lidhura me trafikimin. • Të sigurojë trajnime për operatorët e linjave të drejtpërdrejta për trajtimin e rasteve të trafikimit.

NDJEKJA

Qeveria i vazhdoi përpjekjet për zbatimin e ligjit. Neni 165 i Kodit Penal e kriminalizoi trafikimin për qëllime seksuale dhe punë, dhe përcaktoi dënime prej pesë deri në 12 vjet burg dhe gjobë për veprat në të cilat përfshihen viktimat e rritura, dhe prej pesë deri në 15 vjet burg dhe gjobë për veprat në të cilat përfshihen viktimat fëmijë. Këto dënime ishin mjaft të rrepta dhe, për sa i përket trafikimit për qëllime seksuale, në përputhje me dënimet e përcaktuara për krime të tjera të rënda,

si dhunimi. Në nëntor të vitit 2018, Qeveria e rishqyrtoi Kodin Penal, i cili hyri në fuqi në prill 2019, dhe i riklasifikoi të gjitha veprat e prostitucionit të detyruar si trafikim dhe e rriti dënimin minimal për trafikim të fëmijëve prej tri në pesë vjet burg. Policia, prokurorët dhe gjykatat përdorën metoda të ndryshme për numërimin e rasteve, duke rezultuar në statistika të paqëndrueshme nëpër bazat e të dhënave. Policia inicioi 62 raste të reja të trafikimit (43 raste në vitin 2019) dhe i arrestoi 10 të dyshuar të tjerë për “shfrytëzim të shërbimeve seksuale nga një viktimë e trafikimit” (nëntë në vitin 2019). Autoritetet ndoqën penalisht 20 raste të reja, ku përfshiheshin 32 të dyshuar (43 raste të reja ku përfshiheshin 80 të dyshuar në vitin 2019). Gjykatat i dënuan tre trafikantë (tetë në vitin 2019) dhe e dënuan një autor që “i shfrytëzoi shërbimet seksuale nga një viktimë e trafikimit” (pesë në vitin 2019). Gjykatësit vazhduan të shqiptonin dënime nën dënimin minimal prej pesë vjetësh burg. Një trafikant u dënua me dy vjet me kusht; një trafikant u dënua me gjashtë muaj burg dhe një gjobë prej 5.000 eurove (6.130 dollarë); dhe një tjetër u dënua me tri vjet burg dhe një gjobë prej 500 eurove (610 dollarë). Autori i dënuar për “shfrytëzim të shërbimeve seksuale nga një viktimë e trafikimit” u dënua me një vit burg. Gjykatat e pakësuan numrin e rasteve të pazgjidhura të trafikimit; 68 raste mbetën të hapura nga vitet e kaluara, krahasuar me 74 në vitin 2019).

Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ) e Policisë së Kosovës (PK) i ka hetuar të gjitha rastet e trafikimit përmes tetë njëjësive të veta rajonale, dhe gjithashtu mbajti një njësi në komunat veriore me shumicë serbe. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) vazhdoi ta caktonte një koordinator të posaçëm për trafikim për t’i monitoruar rastet, të ofronte udhëzime dhe të merrte pjesë në task forcë. Qeveria e miratoi PSO-në e re për ta rritur efikasitetin e përpjekjeve për ndjekje penale dhe e caktoi një person kontaktues për çështje të trafikimit në të shtatë prokuroritë themelore. DHTQNJ bashkëpunoi me Inspektoratin e Punës për t’i kryer 77 inspektime të përbashkëta të bareve, klubeve të natës, restoranteve dhe salloneve të masazhit (171 në vitin 2019). Veçmas, DHTQNJ gjithashtu kreu operacione të përbashkëta me Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, Administratën Tatimore dhe Inspektoratin e Punës për t’i kontrolluar 59 bare, nëntë sallone të masazhit, katër shtëpi private dhe tri hotele, që shpuren në mbylljen e përkohshme të 39 lokaleve (78 në vitin 2019). Vëzhguesit raportuan që mungesa e trajnimit dhe e përvojës në raste të trafikimit ndër prokurorë dhe gjykatës rezultoi në dënime të buta ose në raste të uljes në krim më të vogël, posaçërisht të rasteve që përfshinin kontrollin emocional dhe detyrimin psikologjik të viktimës. Përveç kësaj, PK-ja dhe policia kufitare kishin nevojë për udhëzime shitesë se kur do ta klasifikonin lypjen e detyruar të fëmijëve nga prindërit e tyre si trafikim në vend se si mospërfillje ose abuzim prindëror.

ZKPSH i trajnoi gjykatësit dhe prokurorët, dhe Departamenti i PK-së për trajnime, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, mbajti 26 trajnime (48 në vitin 2019). Akademia e Drejtësisë i trajnoi prokurorët, gjykatësit dhe avokatët e viktimave në çështje të trafikimit. Qeveria shkëmbeu informata me qeveritë e huaja në 18 raste të trafikimit (30 në vitin 2019) dhe bashkëpunoi me Shqipërinë, Gjermaninë, Maqedoninë e Veriut dhe Moldavinë në hetime. DHTQNJ, ZKPSH dhe Inspektorati i PK-së bashkëpunuan për t’i hetuar nëpunësit qeveritarë që mund të ishin të përfshirë në krime të trafikimit, por nuk raportuan për ndonjë rast të ri. Korrupsioni dhe përfshirja zyrtare në krime të trafikimit mbetën shqetësime të mëdha, gjë që i pengonin

veprimet e organeve për zbatim të ligjit gjatë vitit. Në vitin 2016, prokurorët ngrenë akuza kundër dy policëve në raste të veçanta për keqpërdorim të dyshuar të pozitës zyrtare dhe shfrytëzim seksual të viktimave të trafikimit. Në vitin 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës e liroi njërin polic nga akuza.

MBROJTJA

Qeveria i shtoi përpjekjet për mbrojtjen e viktimave. Qeveria i identifikoi 17 viktima të trafikimit (26 në vitin 2019). Prej tyre, shtatë ishin viktima të trafikimit për qëllime seksuale dhe 10 ishin viktima të punës së detyruar (20 viktima ishin shfrytëzuar në trafikim për qëllime seksuale, tri në punë të detyruar, dy në “robëri dhe skllavëri”, dhe një në robëri shtëpiake përmes martesës së detyruar në vitin 2019). 15 prej viktimave ishin fëmijë (njësoj si në vitin 2019); shtatë viktima ishin femra dhe tri viktima ishin meshkuj (23 femra dhe tre meshkuj në vitin 2019); të gjitha viktimat ishin nga Kosova (21 viktima ishin nga Kosova, dy nga Serbia, dy nga Mali i Zi dhe një nga Shqipëria në vitin 2019). Reaguesit e parë përdorën tregues standardë për t’i kontrolluar popullatat e cenueshme; megjithatë, vëzhguesit raportuan për mungesë të udhëzimeve dhe përpjekjeve proaktive për identifikim të viktimave të lypjes së detyruar, posaçërisht fëmijëve. Një mekanizëm shumë-disiplinor kombëtar i referimit (MKR) ofroi PSO për identifikimin dhe referimin e viktimave në shërbime. MKR-ja kërkonte që një hetues nga DHTQNJ-ja dhe një avokat i viktimave nga Zyra për Ndihmë dhe Avokim të Viktimave të mblidheshin dhe t’i vlerësonin viktimat si rrezik i ulët, i mesëm ose i lartë, dhe ta koordinonin kujdesin dhe vendosjen e viktimave; MKR-ja gjithashtu kërkoi që një nëpunës social për viktimat fëmijë të merrte pjesë në vlerësim. OJQ-të vazhduan të raportonin që MKR-ja funksiononte mirë dhe theksuan bashkëpunimin e mirë ndërmjet aktorëve.

Qeveria i licenoi dhe pjesërisht i financoi dy strehimore të drejtuara nga OJQ-të për t’u ofruar shërbime viktimave, bashkë me Objektivin për Siguri të Përkohshme (OSP), të drejtuar nga shteti. OSP-ja i strehonte përkohësisht viktimat e trafikimit të vlerësuara si rrezik i lartë, si viktimat me trafikantin e tyre akoma të lirë, viktimat që dëshmonin në procedura gjyqësore ose viktimat që pritnin të riatdhesheshin. Autoritetet kërkonin që viktimat të kishin përcjellje policore jashtë OSP-së gjersa procedurat gjyqësore ishin në vazhdim e sipër dhe kërkonin miratim nga prokurori dhe PK-ja për viktimat që vlerësoheshin si rrezik i lartë për t’u larguar përgjithmonë nga OSP-ja. Objekti i OSP-së kishte kapacitet për t’i strehuar 40 persona në dhoma të ndara për femra, meshkuj dhe familje, dhe viktimat qëndronin mesatarisht 90 ditë para se të transferoheshin në një strehimore të drejtuar nga OJQ-të. Në vitin 2020, OSP-ja akomodoi nëntë viktima (27 viktima në vitin 2019). Të tri strehimoret ofronin ndihmë juridike, shërbime mjekësore dhe psikologjike, këshillim, edukim, shërbime rekreative dhe mbështetje rehabilituese. Gjatë pandemisë, strehimoret administruan gjithashtu testet për COVID-19 për viktima menjëherë pas arritjes, për të siguruar që viktimat e prekura me COVID të merrnin kujdes mjekësor dhe masa paraprake të sigurisë. Qendra për Mirëqenie Sociale (QMS) gjithashtu ofroi shërbime për viktimat fëmijë, por, për shkak të pandemisë, QMS-ja e shkurtoi orarin e punës dhe numrin e punonjësve socialë, duke rezultuar në më pak raste të referuara dhe në sfida për ofrimin e kujdestarisë 24-orëshe. Shoqëria civile raportoi

për cilësi të mirë të kujdesit për viktimat, por programet për riintegrim patën sukses të kufizuar për shkak të mungesës së burimeve dhe shkallës së lartë të papunësisë.

Qeveria ndau 205.000 euro (251.530 dollarë) për mbrojtjen e viktimave, një rritje prej 172.960 eurove (212.220 dollarë) në vitin 2019. Kjo përfshiu një rritje të fondeve për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të pas viteve të financimit joadekuat dhe vonesave burokratike; strehimoret e drejtuara nga OJQ-të morën 105.000 euro (128.830 dollarë), krahasuar me 67.000 euro (82.210 dollarë) në vitin 2019 dhe 70.680 euro (86.720 dollarë) në vitin 2018. OSP-ja mori 100.000 euro (122.700 dollarë), krahasuar me 80.000 euro (98.160 dollarë) në vitin 2019 dhe 2018. Qeveria komunale e Prishtinës gjithashtu siguroi 13.000 euro (15.950 dollarë) për një nga strehimoret e drejtuara nga OJQ-të, krahasuar me 7.100 euro (8.710 dollarë) në vitin 2019. Strehimoret e drejtuara nga OJQ-të raportuan që financimi i qeverisë në vitin 2020 ishte i kënaqshëm. Nuk pati raportime që qeveria i ndëshkoi viktimat për krimet që trafikantët e tyre i detyruan t'i kryenin; megjithatë, për shkak të mungesës së procedurave konsekuente të identifikimit për lypje të detyruar, disa fëmijë mund të kenë mbetur të paidentifikuar brenda sistemit për zbatimin e ligjit. Ligji u jepte të drejtë viktimave të huaja në një periudhë reflektimi prej 90 ditësh, gjatë të cilës viktimat mund të rikuperoheshin përpara se të vendosin nëse do të bashkëpunonin me organet për zbatimin e ligjit. Autoritetet ua siguruan viktimave të huaja të drejta dhe shërbime të njëjta si viktimave vendëse dhe ligji u jepte viktimave të huaja të drejtë për leje qëndrimi të përkohshëm për së paku gjashtë muaj; asnjë viktimë e huaj nuk kërkoi leje në vitin 2020 (njësoj si në vitin 2019). Qeveria ndihmoi në riatdhesimin e tri viktimave (dy në vitin 2019). Të 17 viktimat morën pjesë në hetime duke dhënë deklarata për DHTQNJ-në, prokurorët dhe gjykatësit e procedurës paraprake (26 në vitin 2019). Qeveria raportoi se trafikantët e dyshuar nuk ishin të pranishëm kur viktimat jepnin deklarata dhe viktimat e huaja mund të ktheheshin në vendet e tyre të prejardhjes pas dhënies së dëshmisë, pa prituri për përfundim të gjyqimit. Ligji lejonte kompensim nga shteti nëse viktimat nuk mund të merrnin dëmshpërblim nga trafikantët e tyre; një viktimë i mori 3.000 euro (3.680 dollarë) për dëmtim të shëndetit mendor nga fondi për kompensim (një viktimë fëmijë i mori 2.000 euro (2.450 dollarë) në vitin 2019).

PARANDALIMI

Qeveria i vazhdoi përpjekjet për ta parandaluar trafikimin, posaçërisht për shkak të pandemisë. AKKTP-ja, që përbëhet nga përfaqësueses nga tetë ministri të qeverisë, gjyqësori, zyrat komunale, avokatët e viktimave, OJQ-të dhe vëzhguesit ndërkombëtarë, i koordinoi përpjekjet ndërmjet agjencive dhe prodhoi raporte tremujore, por nuk mbajti mbledhje të rregullta për shkak të pandemisë. Në vitin 2019, qeveria, në konsultim me shoqërinë civile, e hartoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimt kundër Trafikimit 2020-2024; megjithatë, miratimi i saj mbeti pezull, pjesërisht për shkak të vonesave të shkaktuara nga pandemia. Ndërsa shoqëria civile raportoi se AKKTP-ja ishte më pak aktive, ajo theksoi bashkëpunimin e fortë me AKKTP-në dhe koordinatorin kombëtar, përfshirë përgjigjen ndaj rekomandimeve dhe shqetësimeve. Qeveria organizoi një fushatë vjetore njëmuajore të ndërgjegjësimit dhe prodhoi një video mbi lypjen e fëmijëve, por pak ngjarje ndodhën për shkak të përpjekjeve për zbutjen e pandemisë. Veçmas, qeveria shpërndau fletëpalosje lidhur me shërbimet shëndetësore për viktimat e trafikimit dhe

DHTQNJ-ja shpërndau fletëpalosje në pikat kufitare dhe mbajti ligjërata dhe tryeza të rrumbullakëta mbi përpjekjet kundër trafikimit. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e zhvilloi një kornizë ligjore për regjistrimin dhe licencimin e punëdhënësve të sektorit privat, përfshirë agjencitë e huaja të punësimit. Linja e drejtpërdrejtë telefonike për viktime të dhunës në familje dhe të krimeve të tjera, e drejtuar nga qeveria, pranoi 650 thirrje (831 në vitin 2019), përfshirë gjashtë raste të trafikimit të mundshëm (nëntë në vitin 2019). Vëzhguesit raportuan se operatorët kishin nevojë për trajnim për t'iu përgjigjur si duhet thirrjeve lidhur me trafikimin. Qeveria transmetoi një njoftim publik për ta ulur kërkesën për akte të seksit komercial.

PROFILI I TRAFIKIMIT

Siç është raportuar gjatë pesë vjetëve të fundit, trafikantët i shfrytëzojnë viktimat vendëse dhe të huaja në Kosovë, dhe trafikantët i shfrytëzojnë viktimat nga Kosova jashtë vendit. Rrjetet kriminale i shfrytëzonin viktimat për trafikim për qëllime seksuale brenda vendit. Shumë viktime të trafikimit për qëllime seksuale në Kosovë janë vajza, edhe pse trafikantët gjithashtu i detyrojnë femrat nga Shqipëria, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe vende të tjera evropiane të merren me prostitucion. Gratë dhe vajzat shfrytëzohen për trafikim për qëllime seksuale në shtëpi e banesa private, në klube të natës e lokale të masazhit. Fëmijët nga Kosova, Shqipëria dhe vende të tjera fqinje detyrohen të lypin brenda vendit. Trafikantët i nënshtrojnë qytetarët e Kosovës në trafikim për qëllime seksuale dhe punë të detyruar në mbarë Evropën. Komunitetet e marginalizuara të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve janë të cenueshme ndaj lypjes së detyruar dhe trafikimit për qëllime seksuale. Personat LGBTQI+, migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët gjithashtu përjetojnë rrezik më të lartë për trafikim.